

Gjykata komunale për kundërvajtje në Ferizaj, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Bekim Ademi nga Ferizaj, për shkak të veprës kundërvajtëse nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenit 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik ,dhe deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, e në bazë të neneve 31,73 dhe 195 të Ligjit mbi kundërvajtjet,më datën 26.11.2012, muarr këtë:

## AKTVENDIM

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Bekim Sami Ademi nga Ferizaj ,rruga “Luan Haradinaj” nr.14, për veprë kundërvajtëse nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenit 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik ,dhe deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, në mungesë të provave se i pandehuri ka kryer veprën kundërvajtëse të ngarkuar si në kërkesën e AKK ,konform nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të kësaj gjykate.  
Nga një ekzemplarë i këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

### Arsyetimi

Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë,bëri kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr. 01-2193/2012,të dt.04.06.2012,kundër të pandehurit për shkak të kundërvajtjes nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenit 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik ,dhe deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar dhe kërkoi që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtari filloi procedurën kundërvajtëse,morri në pyetje të pandehurin i cili në deklaratën e tij ka theksuar se unë nuk kam pasur dijeni për deklarim të pasurisë pranë AKK, pasi që nuk kam qenë i informuar nga askush e as nga zyrtari komunal-Naser Musa që të bëj deklarimin e pasurisë pranë AKK në Prishtinë se përndryshe do ta kisha bërë këtë deklarim të pasurisë dhe më tej ka shtuar se unë për herë të parë jam këshilltar komunal në Ferizaj dhe kur kam mësuar për këtë çështje menjëher kam shkuar në qendrën e AKK në Prishtinë dhe kam lypur sqarim nga ata se si ka mundur të vij deri te mos informimi im nga ju dhe zyrtari komunal dhe këtu menjëher kam bërë deklarimin e pasurisë që si dëshmi për këtë gjykatës i prezantoi vërtetimin nr.03/3657/12 të dt.28.08.2012,gjyqtari pas marrjes së deklaratës së të pandehurit për vërtetim të gjendjes faktike në mënyrë sa më të plotë dhe reale ka marr në pyetje zyrtarin e pikës kontaktuese për ndërlidhjen e punëve me agjencionin kundër korrupsionit të Kosovës pranë Komunës së Ferizajt Naser Musa,zyrtarin tjetër të KK të Ferizajt Afrim Matoshi si dhe shefin e divizionit për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik pranë AKK –së në Prishtinë -Agron Behrami.

Dy dëshmitarët e parë –zyrtarët e komunal të Ferizajt në deklaratat e tyre të cilat i kanë dhënë në gjykatë kanë theksuar se të gjithë këshilltarët komunal të komunës së Ferizajt të cilët kanë qenë prezent në mbledhjen e asamblesë komunale të dt.09.03.2012 kanë pasur në ulëset e tyre formularët e AKK-së për deklarim të pasurisë të cilët ne atë ditë ua kemi dorëzuar dhe më tej edhe kryesuesi i atëhershëm i asamblesë komunale në Ferizaj Agim Aliu i cili tani mban postin e kryetarit të komunës i ka informuar këshilltarët e pranishëm në mbledhje se formularët e AKK për deklarim të pasurisë duhet të plotësohen dhe të dorëzohen në AKK në Prishtinë dhe në këtë mbledhje përveq të tjerëve ka qenë prezent edhe i pandehuri Bekim siç shifet nga nënshkrimi i tij në regjistrin e anëtarëve pjesmarrës të KK të ,Ferizajt

